



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:179501
Datë: 30.09.2024
Numri i dokumentit: 06229465

Rev.nr.320/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Zenel Leku, kryetar, Beshir Islami dhe Nenad Lazic, anëtar, në çështjen juridike kontestimore të paditëses E.B., nga fshati Ll, Komuna e L., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Avokatura MBN SH.P.K. me avokat Mexhid Syla, Rr. "UÇK-së", hyrja 261, kati I-rë, nr.5, në Prishtinë, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "P", me seli në P., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson A.B., me objekt kontesti kompensim dëmi, vlera e kontestit 49,189.46 €, duke vendosur sipas revizionit të autorizuarit të paditëses, i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.4254/2021 të datës 07.05.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 25.09.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Pranohet pjesërisht i themeltë revizioni i të autorizuarit të paditëses E.B., nga fshati Ll., Komuna e L., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.4254/2021 i datës 07.05.2024 dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Lipjan, C.nr.231/18 i datës 29.10.2020, ndryshohen në pjesën ku është vendosur për kohën nga e cila duhet të rrjedhë kamatëvonesa për kompensimin e dëmit material, ashtu që për dëmin material të gjykuar kamata duhet të rrjedhë nga dita e parashtrimit të padisë, datë 08.06.2018.

II. Në pjesët tjera revizioni i të autorizuarit të paditëses refuzohet i pathemeltë.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Lipjan, C.nr.231/18 të datës 29.10.2020, në pikën I të dispozitivit është aprovuar pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditëses E.B., nga fshati Ll., Komuna L., dhe është obliguar e paditura Kompania e Sigurimeve KS "P"., me seli në P., që në emër të të gjitha formave të kompensimit të dëmit material dhe jo material të shkaktuar nga aksidenti i komunikacionit i datës 07.04.2018 në Prishtinë, paditëses E.B., t'ia paguajë, si në vijim: për dhimbje fizike shumë prej 3,000.00 €; për frikën e pësuar shumë prej 2,500.00 €; për shëmtim trupor shumë prej 3,000.00 €; për shkak të zvogëlimit të përgjithshëm të aktivitetit jetësor shumë prej 13,000.00 €. Në emër të dëmit material t'ia paguajë shumat si vijon: në emër të ndihmës dhe përkujdesit nga personi tjetër shumë prej 300.00 €; në emër të ushqimit të përforcuar shumë prej 300.00 €; në emër të shpenzimeve të mjekimit shumë prej 789.46 €, në emër të rehabilitimit fizioterapeutik shumë prej 70.00 €. Në pikën II të dispozitivit obligohet e paditura që paditëses t'ia paguajë: në emër të dëmit material për fitimin e humbur – rentës, shumat si vijon: në emër të rentës së arritur për periudhën e kaluar prej datës 07.04.2018 - 31.07.2020 shumë prej 6.623.00 €, në emër të fitimit të humbur - rentës në të ardhmen duke filluar nga data 01.08.2020 shumë prej 119.74 € e derisa të ekzistojnë kushtet ligjore. Të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% vjetore, duke filluar nga data e nxjerrjes së këtij aktgjykimi, datë 29.10.2020, e deri në përmbushjen definitive të detyrimit. Në pikën III të dispozitivit obligohet e paditura që në emër të pagesës së shpenzimeve procedurale, paditëses t'ia paguajë shumë totale prej 2,157.60 €, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit dhe në pikën IV të dispozitivit është vendosur që pjesa tjetër e kërkesëpadiës së paditëses E.Byqmeti mbi shumat e aprovuara sikurse në dispozitivin I dhe II të këtij aktgjykimi refuzohet si e pabazuar.

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, Ac.nr.4254/2021 të datës 07.05.2024, janë refuzuar si të pathemelta ankesa e paditëses E.B., nga fshati Ll., Komuna e L., dhe ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve "P"., me seli në P., ndërsa është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Lipjan, C.nr.231/18 i datës 29.10.2020.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë revizion ka paraqitur i autorizuari i paditëses, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale sa i përket lartësisë së kompensimit, shpenzimeve të procedurës dhe llogaritjes së kamatës, me propozim që Gjykata Supreme të aprovoj revizionin e paditëses, të ndryshojë aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, ashtu që të aprovoj kërkesëpadinë e paditëses, të precizuar sipas parashtrësës së datës 04.08.2020.

I autorizuari i të paditurës me përgjigje në revizion ka propozuar që Gjykata Supreme të refuzoj si të pabazuar revizionin e të autorizuarit të paditëses, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.4254/2021 të datës 07.05.2024.

Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 215 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), shqyrtoi aktgjykimin e goditur me revizion, revizionin e të autorizuarit të paditëses, si dhe shkresat e lëndës dhe gjeti se:

Revizioni i të autorizuarit të paditëses është pjesërisht i themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja përmes të autorizuarit të saj, më datë 08.06.2018 në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi për kompensimin e dëmit të shkaktuar në aksident komunikacioni, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "P"., ndërsa me parashtresën e datës 29.10.2020 ka bërë rregullimin dhe precizimin e kërkesëpadisë, duke kërkuar nga gjykata që të aprovohet kërkesa e precizuar.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditëses, ka zhvilluar procedurën gjyqësore dhe ka administruar provat e shtjelluara në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, ku është konstatuar se mes palëve nuk ka qenë kontestues fakti i ndodhjes së aksidentit të komunikacionit ku paditësja ka pësuar lëndime të rënda trupore, ndërsa për natyrën e lëndimit dhe pasojat ka caktuar nxjerrjen e provave me ekspertizë mjekësore nga lëmia e ortopedisë dhe psikiatrisë.

Ekspertët e këtyre fushave, në mendimin dhe konstatimin e përbashkët të dhënë me shkrim më datë 19.02.2020, kanë konstatuar se paditësja në aksidentin e komunikacionit të datës 07.04.2018, ka pësuar lëndime të natyrës së rëndë, të cilat kanë shkaktuar dëme materiale dhe jo materiale te paditësja; dhimbje të intensitetit posaçërisht të rëndë në kohëzgjatje 90 minuta, dhimbje të intensitetit të lartë në kohëzgjatje prej 7 ditësh, dhimbje të intensitetit të mesëm në kohëzgjatje prej 60 ditësh, dhimbje me intensitetit të ulët që ekzistojnë edhe sot e kësaj dite, sidomos gjatë ngarkesës dhe ndryshimit të motit. Sa i përket frikës, paditësja ka pësuar frikë primare në kohëzgjatje prej 2-3 minuta, frikë sekondare të intensitetit të lartë në kohëzgjatje prej 9 ditësh, frikë sekondare të intensitetit mesatar në kohëzgjatje prej 6 muajsh, frikë sekondare e intensitetit të ulët e cila ka zgjatur edhe për 6 muaj të tjerë vijues. Zvogëlimi i aktivitetit të përgjithshëm jetësor është shprehur në përqindje 23.05 %, për shkak të kufizimit të lëvizjes së nyjës së zogut të këmbës së djathtë në shkallë të mesme, e krahasuar me gjendjen e shëndoshë dhe për shkak të kufizimit të lëvizjes së zogut të këmbës së majtë në shkallë të mesme e krahasuar me gjendjen e shëndoshë, kufizimit të lëvizjeve në gjurin e djathtë në shkallë të lehtë, e krahasuar

me gjurin e shëndoshë ku edhe pas operimit, mjekimit, si dhe procedurave rehabilituese konsiston në pamundësinë e paditëses që ti kryej aktivitetet e mëparshme, apo ti kryej me vështërsi ato të cilat i ka kryer para lëndimit pa vështërsi, (aktivitetet punuese) në masa të plota, pastaj detyrat e tjera jetësore, ti plotësoj nevojat dhe dëshirat e saj në jetën private. Shëmtimin trupor të shkallës së mesme për shkak të vrazhës në pjesën e kërcinjëve, si pasojë e plagëve pas operimit të kërcinjëve me gjatësi në kërcirin e djathtë 20 cm dhe gjerësi 1 cm, ushqim i përforcuar ka qenë i nevojshëm në kohëzgjatje prej 70 ditësh, ndihma dhe kujdesi i personit tjetër ka qenë i nevojshëm në kohëzgjatje prej 70 ditësh, rehabilitimi fizioterapeutik ka qenë i nevojshëm në kohëzgjatje prej 45 ditësh.

Gjykata e shkallës së parë me qëllim të konstatimit të dëmit në emër të fitimit të humbur, si pasojë e humbjes së paaftësisë së përgjithshme jetësore dhe asaj të punës, ka angazhuar ekspertin e aktuaristikës A.B., i cili në ekspertizën e hartuar me shkrim të datës 20.07.2020 dhe në mendimin e dhënë në seancën e datës 29.10.2020, ka theksuar se paditësja në emër të fitimit të humbur për periudhën e kaluar prej aksidentit 07.04.2018 e deri më datë 31.07.2020 arrin shumën 6623 €, ndërsa për periudhën e ardhshme prej 01.08.2020 e tutje deri sa për këtë të ekzistojnë kushte ligjore, renta mujore e paditëses do të jetë R=119.74 €, pra shuma e gjithëmbarshme e rentës për periudhën e kaluar dhe për periudhën e ardhshme deri në mars 2025, e paguar në formë të kapitalizuar arrin vlerën prej 12.911.74 €. Eksperti në seancë ka deklaruar se shuma prej 446.92 € në muaj e llogaritur, paraqet pagën mesatare bruto nga e cila pastaj duke e zbritur kontributin pensional dhe tatimin në pagë fitohet paga neto, pastaj konform rregullores së BQK-së duke ju shtuar kontributi pensional fitohet baza për rentë, nga e cila në proporcion të invaliditetit punues të paditëses të caktuar nga eksperti i mjekësisë së punës i caktuar nga gjykata, fitohet definitivisht renta mujore e paditëses, siq është e përcaktuar në kolonën e 8 të pjesës tabelare të rentës së llogaritur.

Gjykata, gjithashtu edhe nga faturat e prezentuara lidhur me shpenzimet e mjekimit dhe të vlerësuara nga ekspertet mjekësor, gjeti se shpenzimet e mjekimit direkt dhe indirekt për paditësen, si dhe rehabilitimi fizioterapeutik - qëndrimi 7 ditor nga ana e paditëses në Banjën e Klllokotit, të gjitha këto të vërtetuara me kuponë fiskal, i përgjigjen në tërësi nevojave për rehabilitimin e paditëses nga dëmet e pësuarat materiale dhe jomateriale si pasojë e aksidentit, andaj të njëjtat gjykata i pranoi pjesërisht, e të gjitha këto bazuar në kuponat fiskal që gjenden në shkresat e lëndës.

Prandaj, gjykata, nga arsyet e paraqitura më lart, mbi bazën e vërtetuar të gjendjes faktike, gjeti se paditëses i takon kompensimi i dëmit material dhe jo material si në pikën I dhe II të dispozitivit, duke vlerësuar se shumat e gjykuara janë të mjaftueshme, koherente me natyrën, kohëzgjatjen, intensitetin e dëmeve materiale dhe jomateriale që paditësja ka pësuar në aksidentin e komunikacionit, për të gjitha kategoritë e dëmeve. Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese, respektivisht shumës mbi shumat e aprovuara, gjykata të njëjtat i refuzoj ngase konsideroj se shumat e kërkuar mbi shumën e aprovuar është mbi shumën e cila nevojitet që gjendja materiale e të dëmtuarës të silltet aty ku do të ishte po mos të kishte ndodhur veprimi dëmtues.

Lidhur me bazën juridike të kërkesëpadisë është vendosur bazuar në nenet 159 paragrafi 1, 169 paragrafi 1 dhe 3, 172 paragrafi 1 dhe 4, 173 paragrafi 1, paragrafi 2 dhe 3, 179 paragrafi 1 dhe 2, 183 paragrafi 1 dhe 2, si dhe nenit 918 të LMD-së. Vendimin lidhur me kamatën gjykata e ka bazuar në nenin 382 të LMD-së dhe aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr.284/2019, datë 07.10.2019, ndërsa për shpenzimet e procedurës është vendosur në bazë të neneve 449 dhe 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit në procedurën e vendosjes sipas ankesave të palëve ndërgjyqëse, ka refuzuar ankesat, me vlerësim se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu ky aktgjykim nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i kanë pretenduar palët ankuese me ankesë.

Si rrjedhojë, Gjykata e Apelit e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, për sa i përket konstatimit të gjendjes faktike dhe zbatimit të drejtë të ligjit material. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, duke marrë parasysh natyrën e lëndimeve, si dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve dhe frikës, është vendosur që të vërtetohen shumat e kompensimit në emër të dëmit jo material të shkaktuar, mbështetur edhe në thëniet e ekspertizave mjekësore ku janë trajtuar këto forma të dëmit, bazuar në nenin 183, paragrafi 2 të LMD-së. Për Gjykatën e Apelit është i pranueshëm edhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë, në lidhje me bazën juridike të kërkesëpadisë duke vlerësuar se kjo gjykatë ka zbatuar drejtë dispozitat e të drejtës materiale të përshkruara në arsyetim të aktgjykimin të atakuar.

Ndërsa, sa i përket shumës së kompensimit të dëmit material për ushqim të përforcuar dhe ndihmë nga personi i tretë, e cila po ashtu është vërtetuar me këtë aktgjykim të gjykatës së shkallës së dytë, Gjykata e Apelit konsideron se kompensimi i tyre, i caktuar nga gjykata e shkallës së parë, është i drejtë dhe i ligjshëm. Kjo, pasi që forma të tilla të dëmit, është e vështirë, e pothuajse e pamundur, që të vërtetohen me prova konkrete, por praktika e gjykatave të Kosovës, njeh forma të tilla të kompensimit, sa herë që konstatohet nevoja për to. Kështu, meqë në këtë rast, në ekspertizë mjekësore është konstatuar se pala e dëmtuar ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar dhe ndihmë nga personi i tretë (për kohën e cekur në ekspertizë) atëherë vërtetohet se të dëmtuarës i takon e drejta në kompensim për këto forma të dëmit, në lartësinë e gjykuar nga gjykata e shkallës së parë. Ndërsa, shumat e kompensimit të dëmit material për shpenzime të mjekimit dhe rehabilitim fizioterapeutik, gjykata e shkallës së parë ka gjykuar shuma të drejta në bazë të provave që ka pasur në dispozicion, siç janë faturat dhe kuponët fiskal të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Gjykata e Apelit ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur edhe lidhur me kompensimin e dëmit material - fitimin e humbur- rentës për periudhën e kaluar prej datës 07.04.2018 deri më datë 31.07.2020 dhe rentën mujore për të ardhmen duke filluar nga data 01.08.2020, e deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore, pasi që mënyra se si ka vendosur gjykata e shkallës së parë është e bazuar në ekspertizën e ekspertit mjekësor dhe ekspertit të lëmisë së punës. Eksperti i lëmisë së punës Dr. Xh.Sh., ka konstatuar se paditësja si pasojë e aksidentit ka pasur zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm punues në masën prej 100 % për 6 muaj pas vitit të parë të aksidentit, paaftësia punuese për punë është 100 %, pastaj për 6 muaj tjerë pas vitit të parë të aksidentit ky zvogëlim ka qenë në masën prej 60 %, ndërsa pas kësaj periudhe është 22.5 %. Në anën tjetër, lartësinë e këtij lloj kompensimit të dëmit e ka përllogaritur eksperti aktuar-financiar A.B., ekspertizën e të cilit gjykata e shkallës së parë me të drejtë ja ka falë besimin, pasi që e njëjta vlerësohet e plotë dhe e hartuar në mënyrë profesionale.

Gjykata e Apelit e pranon si të drejtë edhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, për sa i përket gjykimit të kamatës ligjore, përkatësisht lartësisë dhe kohëzgjatjes së saj, pasi që e njëjta është gjykuar në përputhje të plotë me nenin 382 të LMD-së dhe aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr.284/2019 të datës 07.10.2019, e po ashtu e pranon si të drejtë edhe vendimin për shpenzimet e procedurës, pasi që të njëjtat janë gjykuar në përputhje me nenin 449 dhe 452 të LPK-së.

Nga revizioni i paraqitur nga i autorizuari i paditëses rezulton se kontestimi i aktgjykimit të shkallës së dytë ka të bëjë me shumat e gjykuara në emër të kompensimit të dëmit jo material dhe atë dhimbjeve fizike, frikës, zvogëlimit të aktivitetit jetësor dhe shëmtimit trupor për paditëses, si dhe shpenzimet e procedurës dhe llogaritja e kamatës.

Gjykata Supreme ka trajtuar revizionin në raport me pretendimet e ngritura për zbatim të gabuar të të drejtës materiale dhe në raport me kërkesat për kompensim të gjykuara nga gjykata e shkallës së parë e të pranuar nga gjykata e shkallës së dytë, të kontestuara me revizion, ndërsa në raport me shkeljet procedurale ka trajtuar vetëm shkeljet për të cilat kujdeset sipas detyrës zyrtare (nenit 215 të LPK-së), ngase për këtë bazë nuk është paraqitur revizioni.

Gjykata Supreme e Kosovës, e ka pranuar qëndrimin e gjykatës së shkallë së dytë, duke vlerësuar se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme, në përputhje me gjendjen faktike të provuar, duke e detyruar të paditurën që paditëses t'ia kompensoj shumat e gjykuara si në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së parë, mirëpo kjo gjykatë nuk ka pranuar qëndrimin e gjykatave të instancës më të ulët sa i përket vendosjes lidhur me kohën e rrjedhjes së kamatës për kompensimin e dëmit material, përkatësisht ndihmës dhe perkujdesjes nga personi tjetër, për ushqim të përforcuar, për shpenzime të mjekimit, si dhe për rehabilitim fizioterapeutik, ku në këtë pikë është ndryshuar aktgjykimi i shkallës së parë dhe ai i shkallës së dytë.

Sa i përket bazës juridike të përgjegjësisë, të konstatuar nga gjykatat e dy instancave, Gjykata Supreme pranon këtë qëndrim dhe arsyet që janë dhënë sa i përket detyrimit të paditurës për kompensimin e dëmit paditëses.

Gjykata Supreme ka refuzuar revizionin e të autorizuarit të paditëses dhe kërkesën e tij për ndryshimin e aktgjykimit të shkallës së dytë për dëmin jo material, të gjykuar si në dispozitiv të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, ku në revizion ka pasur pretendim se shumat e gjykuara janë shumë të ulëta, por të njëjtat pretendime janë të pabazuara, pasi aplikimi i dispozitave materialo-juridike, të cilave iu është referuar gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë, është në përputhje me gjendjen faktike, duke marrë në konsideratë natyrën e lëndimeve, llojin dhe intensitetin e dhimbjeve fizike, llojin, intensitetin, kohëzgjatjen dhe mënyrën e manifestimit të frikës, shkallën e zvogëlimit të aktivitetit jetësor dhe të shëmtimit, si dhe rrethanat tjera që ndikojnë në përcaktimin e lartësisë së kompensimit, siç janë mosha e paditëses, praktika gjyqësore, rezulton se shumat e gjykuara janë në përputhje me qëllimin e kompensimit të dëmit në rastin konkret. Nga arsyet që janë dhënë në lidhje me shumat e gjykuara

dhe shumat e refuzuara për të gjitha kategoritë e dëmit, rezulton se gjykata ka pasur në konsideratë rëndësinë e shkëljes së të mirës dhe qëllimin të cilit i shërben ky kompensim, duke u kujdesur që kompensimi t'i përputhet qëllimeve që synohen me kompensimin e dëmit jo material e që është satisfaksion për të dëmtuarën.

Vlerësohet se gjykata e shkallës së dytë ka vendosur në mënyrë të ekuilibruar në mes të shumave të gjykuara dhe natyrës së lëndimeve përkatësisht dëmeve që ka pësuar paditësja E.B., duke siguruar që kompensimi i gjykuar të jetë satisfaksion për paditësen dhe duke shmangur qëllimet tjera materiale që mund të bien ndesh me qëllimin e satisfaksionit në raste të tilla. Në këtë kuptim nuk janë pranuar pretendimet e revizionit të paditëses, për zbatim të gabuar të së drejtës materiale, ngase sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme për këtë pjesë të kërkesëpadisë Gjykata e Apelit ka vendosur në përputhje me gjendjen faktike dhe se shumat e gjykuara i përgjigjen natyrës së lëndimit dhe pasojave si dhe janë në përputhje me dispozitat materiale, përkatësisht nenin 183 të LMD-së.

Gjykata Supreme e vlerëson si të pathemeltë revizionin e të autorizuarit të paditëses edhe sa i përket lartësisë së kamatëvonesës së gjykuar, ku është pretenduar nga i autorizuari i paditëses se kamata është dashur të jetë 12%. Sipas kësaj gjykate, gjykatat e instancës më të ulët do të kishin mundur të gjykojnë lartësinë e interesit vjetor prej 12% (siç është përcaktuar me nenin 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia), vetëm në situatën kur pala paditëse do të dëshmonte se te e paditura ka paraqitur kërkesë për kompensim ndërsa e paditura nuk i është përgjigjur brenda afatit të përcaktuar ligjor prej 60 ditësh, mirëpo në këtë rast në shkresa të lëndës edhe pse ekzistojnë dy kërkesa drejtuar Kompanisë së Sigurimeve "P", në P., njëra e datës 13.04.2018 dhe tjetra e datës 20.04.2018, të njëjtat në pjesën lart (ku do të duhej të ishte pranimi tyre nga ana e KS Prisig), kanë vetëm data të shënuara me dorë dhe nënshkrime të ndryshme, përkatësisht (datë 16.04.2018 dhe 23.04.2018), që nënkupton se të njëjtat nuk dihet a i janë dërguar kësaj kompanie, në mënyrë që pastaj të vlerësohet se a ka pasur mos përgjigje të palës së paditur lidhur me këto kërkesa. Në rrethana të tilla kur pala nuk ka mundur të argumentoj se ka paraqitur kërkesë te e paditura, gjykatat me të drejtë nuk kanë pranuar që kamata të jetë 12%, ngase për tu gjykuar kamata në këtë lartësi duhet që kërkesa paraprakisht të dërgohet te e paditura, ndërsa e paditura të mos përgjigjet në afatin e caktuar ligjorë.

Gjykata Supreme e ka vlerësuar pjesërisht të themeltë revizionin e paditëses lidhur me aplikimin e gabuar të së drejtës materiale sa i përket vendosjes për kamatën, përkatësisht kohës nga e cila duhet të rrjedhë kamata për dëmin material, për faktin se për këtë lloj të dëmit kamata duhet të

rrjedhë nga koha e paraqitjes së kërkesës, respektivisht paraqitjes së padisë në gjykatë, e deri në pagesën e plotë, (ashtu siç është përcaktuar me mendimin Juridik të Gjykatës Supreme Nr.265/2020 të datës 02.12.2020), prandaj nga këto arsye, për këtë pjesë është ndryshuar aktgjykimi i shkallës së parë dhe ai i shkallës së dytë sa i përket kamatës së caktuar në emër të dëmit material, përkatësisht kohës nga e cila është caktuar të rrjedh ajo dhe është vendosur që kamata për dëmin material të rrjedh nga data e paraqitjes së padisë, përkatësisht nga data 08.06.2018. Ndërsa në raport me shumat e gjykuara për dëmin jo material, kjo gjykatë vlerëson se në këtë rast kamata duhet të rrjedh nga dita e marrjes së aktgjykimit, ashtu siç me të drejtë kanë vlerësuar gjykatat e instancës më të ulët dhe ashtu siç është përcaktuar me nenin 382 të LMD-së.

Gjykata Supreme e vlerëson si të pathemeltë pretendimin e të autorizuarit të paditëses për shpenzimet e procedurës, kjo pasi që nga shkresat e lëndës, respektivisht precizimi i kërkesëpadisë i datës 29.10.2020, rezulton se i autorizuari i paditëses ka kërkuar shpenzimet e procedurës në shumën e përgjithshme prej 2,097.60 € dhe 40 euro për taksë gjyqësore, ndërsa gjykata ka aprovuar shumën e shpenzimeve në lartësi prej 2,157.60 €, që nënkupton se gjykatat i kanë njohur të autorizuarit të paditëses vlerë më të lartë të shpenzimeve se ajo e kërkuar me precizimin e lartcekur, andaj kjo gjykatë vlerësoj se gjykatat e instancave më të ulëta, vendimin për shpenzimet e procedurës e kanë marrë në mbështetje të nenit 449 dhe 452 të LPK-së.

Gjykata Supreme e Kosovës me rastin e vendosjes sipas këtij aktgjykimi, ka vlerësuar të gjitha pretendimet sipas revizionit të paraqitur, mirëpo ka gjetur se janë të pabazuara dhe pa ndonjë ndikim për vendosje ndryshe, për çka edhe ka vendosur kjo gjykatë me anë të këtij aktgjykimi.

Nga sa u tha më lart e në pajtim me nenin 222 dhe 224 paragrafi 1 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

Rev.nr.320/2024, më 25.09.2024

Kryetari i kolegjit - Gjyqtari
Zenel Leku